

## Lajmet më të fundit mbi COVID-19 për banorët - Numri 24

Të nderuar Banorë,

Ky është numri më i fundit i buletinit tuaj. Ky numër ofron një azhurnim mbi vaksinën e ardhshme të gripit si dhe informacion për prindërit e fëmijëve që shkojnë në shkollë. Ne i inkurajojmë të gjithë banorët të ndajnë pak kohë për tu njohur me informacionin e dhënë.

Ky buletin është gjithashtu në dispozicion në faqen e internetit për qendrat e akomodimit nën seksionin 'Banorët' së bashku me përkthimet në gjuhë të ndryshme.

Ju lutemi na tregoni se cilat tema dëshironi t'i shihni në buletinët e ardhshëm duke dërguar email në [ipasinbox@justice.ie](mailto:ipasinbox@justice.ie).

Në fund, dëshirojmë t'ju falënderojmë për bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm dhe ju urojmë shëndet të mirë.

**Ekipi IPAS**



## Vaksina kundër gripit

Ndërsa po i afrohem dimrit, HSE po inkurajon njerëzit që të marrin vaksinën kundër gripit për të mbajtur të sigurt veten dhe familjet e tyre.

Vaksina kundër gripit për grupet e rrezikuara do të jetë në dispozicion nga fundi i Shtatorit 2020. Vaksina kundër gripit për fëmijët do të jetë në dispozicion nga mesi i Tetorit 2020.

Ju lutemi klikoni në lidhjet e mëposhtme për të parë një video në lidhje me vaksinën kundër gripit për grupe e rrezikuara dhe fëmijë e moshës 2-12 vjeç në gjuhë të ndryshme: [Urdu](#); [Russian](#); [Romanian](#); [Portuguese](#); [Polish](#); [Mandarin](#); [French](#); [Arabic](#).

Për më tepër, një seri broshurash të përkthyera dhe udhëzues të thjeshtë për t'u lexuar mbi vaksinën kundër gripit janë në dispozicion për t'u shkarkuar në faqen e internetit të HSE. Për informacione të mëtejshme, ju lutemi klikoni [këtu](#).

## Azhurnimi rreth Shkollave

Shkollat tani janë të hapura në mënyrë që nxënësit të kthehen në shkollë. Informacioni për prindërit dhe familjet është në dispozicion këtu: <https://www.gov.ie/en/publication/a04fc-advice-for-students-and-their-families/>.

Për të minimizuar rrezikun e përhapjes së COVID-19 në komunitetin e shkollës, është e rëndësishme që fëmijët të qëndrojnë në shtëpi nëse nuk ndihen mirë ose nëse janë këshilluar nga shëndeti publik që të vetë-izolohen.

Askush nuk duhet të shkojë në shkollë nëse nuk është mirë ose ndonjë anëtar i familjes së tyre nuk është mirë me simptoma që përputhen me COVID-19.

Nëse prindërit janë informuar nga këshillat e shëndetit publik që fëmija i tyre duhet të vetë-izolohet, fëmijët nuk duhet të shkojnë në shkollë.

Shërbimi i Mbështetjes së Arsimit TUSLA po punon gjithashtu me IPAS për të mbështetur të gjithë nxënësit që të kthehen në shkollë dhe është në dispozicion për të siguruar udhëzime dhe këshilla për prindërit/kujdestarët.



## Aktivitetet e Qendrës - Birchwood House

Gjatë muajve të verës, Menaxherët e Qendrës prezantuan një sërë aktivitesh për banorët.

Në Birchwood House në Waterford, stafi organizoi një kamp veror për fëmijët në qendër. Një nga pikat kryesore përfshinte vendosjen e këndit/bibliotekës së leximit për fëmijë me vizita nga artistë / tregimtarë vendas. Qendra tani ka filluar të krijojë një kopsht zanash, me një pjesë të luleve të egra për bletët.

Përveç kësaj, qendra ka vendosur një politunel dhe banorët kanë filluar të kultivojnë lakër jeshile, brokoli, marule, etj.

Këtu janë disa fotografi të rezultateve të aktiviteteve në Birchwood House:



Nëse dëshironi të ndani disa fotografi të aktiviteteve që zhvillohen në qendrën tuaj, ju lutemi kontaktoni [IPASinbox@justice.ie](mailto:IPASinbox@justice.ie).

## Linja telefonike ndihmëse falas për banorët – 1800 929 008

Është vendosur një linjë telefonike ndihmëse falas për të mbështetur banorët gjatë COVID-19.

Ne e kuptojmë që jo të gjithë ndihen rehat të kontaktojnë drejtpërdrejt me Ministrinë, kështu që është e rëndësishme të dini se ndërsa IPAS vendosi këtë linjë ndihmëse, ajo drejtohet nga një organizatë bamirësie - Shërbimi i Refugjatëve Jesuit (Irlandë).



Merrni këtë buletin përmes WhatsApp ose e-mail

Nëse dëshironi që Menaxheri i Qendrës tuaj t'ju dërgojë këtë buletin duke përdorur listat e Transmetimeve WhatsApp ose listat e shpërndarjes me e-mail, ndiqni udhëzimet e mëposhtme:

1. Jepni menaxherit të qendrës tuaj pëlqimin me shkrim duke deklaruar se dëshironi t'ju shtojnë në WhatsApp Broadcast për të marrë buletin.
2. Pyetni menaxherin e qendrës tuaj për numrin e tyre të smartphone dhe shtoni këtë numër në librin e adresave të telefonit tuaj.



Menaxheri i qendrës suaj mund të përdorë listën e WhatsApp Broadcast për t'ju dërguar një link në mënyrë që të lexoni këto buletinë në internet. Kjo do t'ju ndihmojë që të jeni të azhurnuar për të gjitha të rejat më të fundit në lidhje me COVID-19.

Nëse nuk dëshironi të merrni më linkun për buletinët përmes WhatsApp ose e-mailit, ju lutemi kërkoni nga menaxheri i qendrës tuaj t'ju heqë nga listat e tyre të shpërndarjes.



Ju lutemi na tregoni në [ipasinbox@justice.ie](mailto:ipasinbox@justice.ie) nëse ka tema të tjera që dëshironi t'i mbulojmë në buletinët tane. Shpresojmë që informacioni i dhënë këtu ishte i dobishëm.

**Me dëshirat më të mira nga ekipi në IPAS dhe Ministria e Drejtësisë dhe Barazisë**



An Roinn Dlí agus Cirt  
agus Comhionannais  
Department of Justice  
and Equality

Informacioni në këtë azhurnim i kushtohet banorëve të qendrave të akomodimit IPAS, Grupeve të Miqve të Qendrës dhe kolegëve të OJQ-ve. Çdo pyetje ose ide mund të drejtohet në [IPASinbox@justice.ie](mailto:IPASinbox@justice.ie).